



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE SIGURISË
PUBLIKE

Nr. 2342/1 prot.

Tiranë, më 08.11.2024

Lënda: Mbi bashkërendimin e projektligjit “Për kontrollin e kufirit shtetëror”

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 9269/6 prot., datë 28.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 2342 prot., datë 31.10.2024, me anë të së cilës dërgoni për bashkërendim projektligjin “Për kontrollin e kufirit shtetëror” (në vijim “projektligji”), relacionin shoqërues, tabelat e përputhshmërisë me legjislacionin evropian, si dhe raportin e vlerësimit të ndikimit (RIA).

Nga shqyrtimi i projektligjit të ridërguar dhe dokumentacionit shoqërues, Zyra e Komisionerit vlerëson në tërësi marrjen në konsideratë të sugjerimeve të dhëna nga ana jonë me shkresën nr. 1905/1 prot., datë 12.09.2024, të cilat janë përfshirë konkretisht në nenet 6/a/ii, 32, 33 dhe 34 të tij.

Me reflektimin e propozimeve të mësipërme, ky projektligj konsiderohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, e për rrjedhojë Zyra e Komisionerit shprehet dakord me Projektligjin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi